

Disa dekada kulla ka qenë sfidë për shumë dashamirës të malit, mes të cilëve shpesh edhe për një numër të madh të pensionistëve. Edhe sot, ajo është sfidë për popullatën më të moshuar, ngjitja e të cilëve në "Kulmin e Sharrit" te kulla e gurit është sfidë e madhe

KULLA E GURIT NË MAJËN E TITOS, SFIDË PËR SHUMË PENSIONISTË



Tetovë, 22 korrik – "Deri sa të më mbajnë këmbët dhe më lejon gjendja shëndetësore, nuk do të dorëzohem nga ecja nëpër male, veçanërisht nëpër Sharr. Ndërsa çdo "pushtim" i Majës së Titos, për mua është përjetim i ri, edhe pse këtë hapësirë e njoh si vetveten", është shprehur Dime Gjoçevski, ndoshta pensionisti më i vjetër në Tetovë, i cili që kur di për veten, vazhdimisht shoqërohet me malet. Pikërisht ai, Dime Gjoçevski, mirë e mban mend kur në vitin 1957, në majën më të lartë të Malit Sharr - Maja e Titos (2747), është ndërtuar Kulla e gurit, në të cilën vizitorët do të mund të strehohen nga moti i keq, të pushojnë ose thjesht në kushte ideale të motit, pamjet e tyre të mbarojnë diku deri te Fusha e Selanikut.

Disa dekada kulla ka qenë sfidë për shumë dashamirës të malit, mes të cilëve shpesh edhe për një numër të madh të pensionistëve. Edhe sot, ajo është sfidë për popullatën më të moshuar, ngjitja e të cilëve në "Kulmin e Sharrit" te kulla e gurit është sfidë e madhe. Nga shumë shoqata të pensioni-

stëve organizohen grupe alpiniste deri te Maja e Titos, veçanërisht për festën më të madhe të Maqedonisë - Ilinden. Mbetet e hapur çështja nëse do të ndodh edhe këtë vit, duke marrë parasysh masat kundër pandemisë së korona virusit. Përndryshe, ecja për pushtimin e Majës së Titos dhe qëndrimi te kulla e gurit, fillon nga Kodra e Diellit. Nga aty, përgjatë kreshtës deri te maja, ecet disa orë. Vetëm aventuristit Goran Haxhiilovski - Çajka para disa viteve i ka shkuar për dore të ngjitet dy herë, një herë me motor dhe herën e dytë me makinë "Fiqo" me motor të fuqizuar.

Kulla e gurit - simboli i Malit Sharr më shumë se 20 vite ka qenë

e lënë buzë shkatërrimit, duke u shndërruar një gërmadhë të vërtetë. Para rreth pesë viteve, anëtarë të Shoqatës alpiniste "Argentus mount" ngritën iniciativë për rikonstruktim. Sipas informatave nga anëtarët e kësaj shoqate, Toni Jovanovski dhe Zija Jonuzi, kullës i është vendosur derë e aluminit, ndërsa me ndihmën e anëtarëve dhe donatorëve të tjerë, është realizuar rikonstruktimi edhe i kullës dhe i është dhënë pamja e parë. Kjo ka krijuar kushtet të shënohet jubileu i 60 vite të ekzistimit të kullës dhe të mundësohet qëndrim i dashamirëve të malit dhe ngjitja e maleve nga të gjithë individët, grupet ose shoqatat e interesuara.

Është interesante përjetimi i dy

alpinistëve të pasionuar nga Tetova, Nadir Murseli dhe Zoran Majstorovski, të cilët janë organizuar dhe Vitin e Ri 2001 e kanë pritur pikërisht në kullën e atëhershme të rrënuar.

Për Malin Sharr deri tani kanë shkruar shumë shkrimtarë. I hanim emrat e Miloško Veselinović, Jovan Zhujović, Edvard Pajnić, Pavle Vujović, Jovan Cvijić, Risto Nikolić dhe shumë të tjerë. Shkrimtari i njohur Ami Bue qysh në vitin 1840 ka shkruar që "e ka zbuluar Malin Sharr", ndërsa në vitin 1876 inxhinieri Jenish nga Austria ka shëtitur dhe ka qëndruar në Sharr. Në mision të ngjashëm ka qenë edhe d-r Estraj nga Gjermania në vitin 1898. Megjithatë,

gjurmë më të madhe ka lënë Dushan Krivokapiq me monografinë "Mali Sharr", e botuar në vitin 1969 në Beograd. Në hulumtimin e tij, Krivokapiq në një vend shkruan, "Mal i lartë, i krijuar që të mahnitë, peizazhe të mrekullueshme me gështenja të buta, pyje të egra të errëta, kullota të buta të gjelbra, shkëmbete të mprehta, shpatie të buta, lugina të errëta, përrenj të qeta me ujëvara, shumë liqene malore... Në diçka të gjithë pajtohen që Sharrin është i gjatë 76 kilometra dhe është me më së shumti maja më të larta se 2.500 metra lartësi mbidetare. Ja, pikërisht të asi lloji, tre janë në afërsi të Kullës së gurit, Maja e Titos, e cila më shumë herë varësisht nga momentet historike, e ka ndryshuar emrin, ndërsa emri i tanishëm është më jetëgjatë – që nga viti 1956, pastaj Turku i Vogël (2.702 metra) dhe Bakrdan (2.700 metra).

Për Malin Sharr ka shumë përralla, legjenda dhe të vërteta. Me këtë mal lidhet rasa e njohur e qenve "qeni i Sharrit" me të gjitha specifikat e tij, ndërsa më së shumti si një mik besnik.

Pensionistët e pasionuar alpinistë dhe jo vetëm nga Tetova, edhe këtë verë paralajmërojnë vizitë dhe shëtitje nëpër Sharr. Disa do ta bëjnë dhe do të ngjiten deri te Kulla e gurit, si objekt në lartësinë më të madhe në vendin tonë. Neve na mbetet t'ju urojmë shëndet dhe plotësim të dëshirës së tyre. Gojko Eftoski

LP STRUGË

INTERNET TURNEU I PARË I PENSIONISTËVE NË SHAH

Shkup, 22 korrik - Edhe krahas pandemisë, jeta e shahut vazhdon dhe më nuk ka vende ku nuk organizohen gara. Kuptohet, duhet të respektohen rekomandimet nga organet kompetente për siguri të shëndetit. Shfaqja e korona virusit nuk e la imun as shahun e Maqedonisë. Ditët e fundit të muajit qershor, Shoqata e pensionistëve nga Struga, e organizoi Internet-turneau e parë të pensionistëve në shah. Sipas iniciatorëve për mbajtjen e Turneut të parë të shahut të këtij lloji, personat e parë të LP Strugë, kryetari Milorad Trposki dhe sekretari Izeir Mustafai, në konkursin për garën janë paraqitur 18 shahistë nga vendi jonë, ndërsa mes tyre edhe një femër-shahiste, e cila e ka fituar vendin e katërt. Në fillim të turneut, të gjithëve pensionistëve shahistë,



kryetari i LP Struga, Milorad Trposki dhe sekretari Izeir Mustafai iu uruan pjesëmarrjen në Internet-turneau e parë në shah 2020, me dëshirën që ky të jetë vetëm fillimi dhe nxitje për organizim të mëtejshëm dhe zgjerim të tij dhe

turneu të bëhet turne tradicional i pensionistëve shahistë në vendin tonë dhe më gjerë.

Shahisti me përvojë, Bajram Spahiu, anëtar i ekipit të shahistëve të LP Strugë, i cili gjithashtu, është njëri prej iniciatorëve dhe i

cili në mënyrë aktive u kyç në organizimin e internet-turneut, theksoi se edhe krahas të gjithave, duhet të dihet që shahu standard dhe internet shahu janë dy sporte të ndryshme. "Shahu përmes internetit është më shumë si video lojë me elemente të shfaqjes. Problemi i madh është që nuk ka kontroll të mjaftueshëm që të parandalohen ata që mashtrjnë", u shpreh Spahiu.

Në fund të turneut u shpallën pesë shahistët më të mirë edhe atë, vendin e parë e fitoi Todor Milosiev nga LP Koçan i moshës 71 vjeçare, vendin e dytë e fitoi Vladimir Micov gjithashtu nga LP Koçan i moshës 66 vjet, vendi i tretë i takoi Tome Todorovskit, i moshës 67 vjeçare nga LP Manastir, përderisa vendin e katërt e mori femra e vetme shahiste, Marija Organxhieva

nga LP Veles, e moshës 61 vjeçare, ndërsa vendi i pestë i takoi anëtarit të LP Dibër dhe Qendra Zhupë, Rizvan Koleci 79 vjeçar.

Internet turneun e parë të shahut në organizim të LP Strugë, e përkrahën Hoteli "Arti", i cili siguroi nga dy ditë vikend për nga dy anëtarë nga familja e fituesve, restoranti "Centar", i cili siguroi ushqim me nga tri shujta dhe "Vebla-Inxhenerik", Projekt Struga i cili i siguroi tavolinat e shahut, shpërblymimet - diploma dhe suvenire, ndërsa dorëzimin deri te secili pjesëmarrës përmes Kargos e siguroi organizatori i turneut, LP Struga. Mbi të gjitha, ngjarje e bukur, e cila solli freski në këto ditë pandemie te pensionistët, të cilën duhet ta përcjellin edhe shoqatat tjera me iniciativat e tyre origjinale. Stojan Kukuneshovski.